



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.467/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës IRDK, me seli në Pejë, kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane PLE, me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.467/2025 e datës 08.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 08.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik IRDK, me të cilën pretendon se Partia Liberale Egjiptiane, më dt. 07.02.2025, ka mbajtur tubim zgjedhor në Komunën e Gjakovës, përkatësisht shkollën "Zekirja Rexha" Gjakovë. Gjatë këtij tubimi, përkatësisht intervalit kohor mes orës 18:30 dhe 19:30, në fjalën e tij, ndër të tjerash, nënkyetari i Partisë Liberale Egjiptiane, Bashkim Krasniqi është shprehur: ...*a e meritojmë more na edhe ato projekte qe i kem, edhe ato projekte me iu hi në hise (...) atyre të varférve (...) me iu marre hisen edhe atyre; o nuk e meritojmë na; për ata duhet me dale edhe me i ndeshku ata, jo për me iu dhanë votë, po edhe me i perzanë edhe prej lagjeve, edhe prej shpiave, edhe prej krejt, hiç mos me i lanë kurrkund.*

Nga të lartcekurat qartazi kuptohet se nënkyetari i Partisë Liberale Egjiptiane, Bashkim Krasniqi, përmes manipulimit me tërësinë e fjalëve të strukturuara në fjalitë e transkriptuara në këtë ankesë, duke shpifur, (1) nxjerre konstatim të rrejshëm se IRDK iu ka hy në hise të varférve, duke nënkuptuar se kinse i ka vjedhur ata dhe (2) jep deklarate tejet të rrezikshme që jo vetëm nxite urrejtje por edhe është thirrje e hapur për dhunë tek masa duke thënë "...duhet me dale edhe me i ndeshku ata, jo për me iu dhanë votë, po edhe me i përzënë edhe prej lagjeve,

edhe prej shpiave, edhe prej krejt, hiç mos me i lane kurrkund..." ashtu që përderisa flet për ndëshkim me votë dhe duke e pas vetëm një oponent politik IRDK-në, meqë komuniteti egjiptian ka vetëm dy parti: IRDK dhe PLE, kuptohet se e ka fjalën për IRDK-në dhe në vetvete një deklaratë e tillë është tejet nxitëse për urrejtje dhe dhunë ndaj një targeti konkret, pra kandidatëve të IRDK-së, duke provokuar haptazi prodhim të pasojave të paparashikueshme të urrejtjes dhe dhunës.

Andaj në kuptim të lartcekurave dhe sipas ligjit në fuqi, përkatesisht nenit 34 (1.11) të Ligjit Nr. 08/1-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nënkyetari i Partisë Liberale Egjiptiane, Bashkim Krasniqi, ka përdorur gjuhën, në formën gojore, duke nxitur ose provokuar, ose duke mundur të nxisë a provokojë në urrejtje kundrejt të tjerëve, që përbën veprim të ndaluar të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 10.02.2025, Subjekti Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), thekson se nënkyetari Bashkim Krasniqi gjatë një tubimi të mbajtur në shkollën Zekirja Rexha në Gjakovë, përmes deklarimit të tij ka nxjerr konstatim të rrejshëm dhe në atë mënyrë ka bërë nxitje, urrejtje dhe pretendime tjera të paraqitura nga IRDK.

Konsiderojmë se Bashkim Krasniqi, askund në asnje pjesë të deklarimit të tij nuk ka përmendur emrin e partisë IRDK dhe tëasnje kandidati të saj, për më tepër Bashkimi Krasniqi në deklarimin e tij ka pas për qëllim të paraqes një gjendje reale faktike ku ka përdor gjuhë normale që bëhet gjatë fushatës zgjedhore ngase në asnje pjesë të deklarimit të tij nuk bëhet shkelje e rregullave zgjedhore. Andaj, nëse merret e përvetësohet deklarim që bëhet në fushatë zgjedhore, kur në deklarime nuk përmendet asnje emër i partive politike,asnje simbol dhe asnje numër i subjektit politik IRDK, atëherë kjo është tërësisht e pa drejtë dhe e palogjikshme që të përvetësohen deklarimet e secilit kandidat dhe të merren kinse iu është drejtuar atyre.

Kundërshtimi ka të bëjë me atë se IRDK ankesën e ka paraqitur pa ofruar asnje provë ku flitet për subjektin IRDK dhe nga incizimi shihet qartë se deklarimi i Bashkim Krasniqit është një deklarim normal që bëhet nëpër fushatë zgjedhore, ngase partitë politike secila e ka qëllimin e arritjes së një suksesi në fushatë dhe garë politike dhe assesi deklarimi i tij nuk ka të bëjë me IRDK dhe measnje parti të caktuar, por ka të bëjë me fenomenin dhe ndodhitë në Kosovë që tashmë janë publike në gjitha mediat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PLE, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik IRDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër përf t'kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografji, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".

Paneli ka refuzuar pretendimin në ankesë për arsy se, në bazë të shkresave të lëndës ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Diskursi i tille i përdorur nga kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti politik nga nënkyetari i Partisë Liberale Egjiptiane, Bashkim Krasniqi, nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika l.11), e LZP-së.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nen 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë
Anr.467/2025 më datë 11.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.